

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Naime Ahmeti, kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët porot Basri Reqica e Pelivan Zhuri, anëtar, në çështjen juridike të paditëses B.A. nga P., Lagja K. e T., Rr."I.F.", nr. ..., të cilën e përfaqëson V.Rr. avokat nga P., sipas autorizimit, kundër të paditurit B.H. nga P., me banim në F.K., Rr."V.F.", nr...., për besimin e fëmijës dhe caktimin e kontaktit, në seancën kryesore jo publike të mbajtur në prani të autorizuarit të paditëses dhe të paditurit, me dt.11.12.2018, mori dhe shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkes padia e paditëses B.A.nga P., ashtu që fëmija i mitur E.H.1, i lindur me ... në P., i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim, nënës së tij B.A. nga P..

II. Kontakti në mes të paditurit B.H. dhe fëmijës të përbashkët E.H.1, është i lirë me marrëveshje mes tyre.

Shpenzimet procedurale i ka hjek paditësja.

A r s y e t i m i

Paditësja nëpërmjet të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi me dt.12.09.2018, kundër të paditurit, për besimin e fëmijës dhe caktimin e kontaktit. Ka theksuar se me të paditurin gjatë bashkëjetesës së tyre kanë fëmijën e përbashkët E.H.1, ndërgjyqësit në fillim kanë pas raporte të mira mes veti, mirëpo pas lindjes së fëmijës ata janë ndarë, kështu paditësja për shkak të kushteve ekonomike ka qenë e detyruar që ta le fëmijën me të paditurin. Më tej ka shtua se pas ndarjes paditësja e ka pas të vështirë ta shoh fëmijën e saj, pasi i padituri ka krijuar jetë të re, ndërsa që paditësja e pa punësuar dhe në gjendje të rëndë ekonomike, ndërsa tani ajo jeton dhe punon në Gj., ku e ka të rregulluar lejeqëndrimin dhe ka një vend pune dhe të ardhura të mira mujore, tani e njëjta është në gjendje që ta mbajë fëmijën e vet, të kujdeset për shkollimin, veshëmbathje dhe ushqim. Në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes dhe fjalën përfundimtare i autorizuari i saj ka mbetur pranë padisë së ushtruar, duke u mbështetur në provat dhe në mendimin e QPS në F.K. dhe të atij në P., ka theksua se janë krijuar kushtet që paditëses ti besohet në ruajtje dhe edukim fëmija E.H.1, meqenëse edhe i padituri ka dhënë pëlqimin, andaj ka propozuar gjykatës që të aprovon kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, ndërsa që gjykata po ashtu të vendos edhe për caktimin e kontaktit sipas marrëveshjes së palëve ndërgjyqës, meqenëse nuk është kontestues besimi.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

I padituri në seanca gjyqësore dhe në atë të shqyrtimit kryesor të çështjes ka deklarua se nuk e kundërshtoj kërkesëpadinë e paditëses për besimin e fëmijës, mirëpo kërkoi që të më mundësohet kontakti me fëmijën E.H.1. Ka theksua se me paditësen jemi ndarë qysh para lindjes së fëmijut gjatë kohës së shtatëzarisë, mirëpo paditësja ka realizuar kontaktin me

fëmijën. Ka theksua se paditësja në kohën e ndarjes nuk ka pas kushte ekonomike që ta mbajë fëmijën, ndërsa tani fëmija është i moshës ... vjeç, i njëjti ka pas kontakt me nënën e tij gjatë vizitave të saja dhe në familjen e saj nuk është pengua fëmiju që ti vizitoj dajtë e tij. Po ashtu ka theksua se gjatë vitieve ...-... ka qenë së bashku me familje me vendqëndrim të përkohshëm në shtetin e Gj., ashtu që paditësja edhe gjatë kësaj periudhe ka pas kontakt me fëmijën e përbashkët, andaj ka propozuar gjykatës që të vendos sipas padisë së paditëses, ndërsa ka propozua që kontakti të jetë i lirë.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Përfaqësuesi i QPS në P. N.G. në seancën e dt. 22.11.2018, ka deklarua mbetemi pranë raportit të dorëzuar gjykatës, se me paditësen kemi biseduar përmes telefonit e cila ka shpreh dëshirën që fëmija i përbashkët E.H.1, ti besohet asaj në ruajtje dhe edukim, kontakti në mes të nënës-paditëses është realizuar që nga viti ... në zyrat e qendrës, nga të cilat vizita është parë një dëshirë e madhe e nënës që ta ketë fëmijën në përkujdesje, mirëpo e njëjta nuk ka pas kushte materiale për këtë. Gjatë vizitave po ashtu është vërejte se fëmija është i lidhur emocionalisht me nënën dhe reciproke edhe me babain, kurse sa i përket gjendjes së tanishme ka propozuar që të merret edhe mendimi i fëmijës, meqenëse është në moshën mbi ... vjeç.

1. Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit mbi Familjen, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendos në këtë çështje.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent.

2.Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja me padi ka kërkuar besimin e fëmijës së mitur E.H.1, ashtu që ka propozuar që ai ti besohet në ruajtje dhe edukim, ndërsa që ka kërkuar caktimin e kontaktit në mes të fëmijës së mitur dhe të paditurit, duke theksua se në kohën e ndarjes me të paditurin nuk ka pas kushte për mbajtjen e fëmijës, kurse tani e njëjta punon dhe ka kushte materiale që të kujdeset për mirëqenien e fëmijës.

I padituri nuk e ka kundërshtuar kërkesë padinë e paditëses që fëmija ti besohet asaj, duke theksua se paditësja fëmijën ia ka besuar atij deri më tani për shkak se nuk ka pas kushte materiale që ta mbajë, mirëpo e njëjta e ka kontaktuar fëmijën sa herë që ka pas nevojë, ashtu që ka propozuar që gjykata të vendos sipas padisë së paditëses, ndërsa që ka propozuar që kontakti të jetë i lirë.

3.Provat e administruara

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: ekstrakin e lindjes për fëmijën E.H.1, lëshuar me dt. 20.08.2018 nga ZGJC Prishtinë, kopja e lejenjofimit për paditësen lëshuar me dt. 29.08.2018 MPB Prishtinë, anamneza sociale e QPS në F.K. nr...dt. 29.10.2018, anamneza sociale e QPS në P. nr.... dt. 26.10.2018, kontrata

e punës për paditësen në Postën D., dhe ekstrakti i të ardhurave për paditësen si dhe fotodokumentacioni i kushteve të banimit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se duhet të vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Faktet

Nga ekstrakti i lindjes, gjykata vetëtoi faktin se fëmija i mitur E.H.1 ka lindur me dt.... në P., nga prindërit B.A.dhe B.H..

Nga raporti i Qendrës për punë sociale në F.K., konstatohen të dhënat sintetike për të paditurin, gjendja materiale e banimit dhe financiare e tij, ku është konstatuar se nuk e kundërshton që fëmija i përbashkët E.H.1 ti besohet nënës së tij-paditëses e cila tani jeton në Gj.. Gjatë vizitës së bërë dhe gjatë bashkëbisedimit me fëmijën E.H.1, është deklaruar se dëshiron me vullnetin e tij dhe pa presion të askujt të jetoj me nënën e tij. Duke theksuar se fëmija e mbanë kontaktin me nënën e tij çdo herë sa herë që vie te familja e saj, e cila është realizuar pa asnjë problem, e po ashtu fëmija i ka të lira edhe vizitat tek dajët e tij edhe pa prezencën e e paditëses dhe i njëjti ka lidhje emocionale me të dhe e respekton si çdo nënën e mirë që kujdeset për të, për këtë arsye i padituri ka deklaruar që djali E.H.1 ti besohet në përkujdesje dhe edukim nënës biologjike e cila jeton jashtë shtetit, andaj edhe mendimi i qendrës është që fëmija E.H.1 të besohet në ruajtje, edukim dhe shkollim nënës së tij B.A.

Nga raporti i Qendrës për Punë Sociale në P., është konstatuar se gjatë bisedave telefonike që kanë pas me paditësen ajo ka konfirmuar se jeton dhe punon në Gj., mirëpo nuk ka mund që të vij në Kosovë por ka dërguar një deklaratë me shkrim përmes imelit ku shkruan se jetoj dhe punoj në Gj. në adresën B. ..., W. dhe është e interesuar për besimin e fëmijës, meqë ka edhe marrëveshje me ish bashkëshortin e saj. Ka deklaruar se ka kushte të mira materiale dhe të banimit andaj është në interesin e fëmijës që ai të më besohet mua. Andaj qendra në P. nuk ka mund të japë mendim konkret në lidhje me besimin e fëmijës meqenëse paditësja nuk jeton në P., mirëpo nëse i padituri jep pëlqimin që fëmija ti besohet asaj, ne si qendër e përkrahim dëshirën e tij, mirëpo në çdo rast kanë propozuar gjykatës që të merret edhe mendimi i fëmijës, meqë është në moshë që ligji lejon të merret edhe mendimi dhe dëshira e tij.

Sipas mendimit të QPS në P. dhe propozimit të palëve ndërgjyqës e konform nenit 144 par.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës, gjykata ka marrë parasysh edhe dëshirën e fëmijës, i dëgjuar në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, ku gjatë bashkëbisedimit me fëmijën pa prezencën e palëve është deklaruar se vijon klasën e ... të shkollës fillore, ndërsa në pyetjen se me kënd ka dëshirë të qëndroj më shumë, është përgjigjur deri më tani kam qëndruar me babain, mirëpo nënën e kam pa çdo herë gjatë vizitave të saj në Kosovë dhe kam pas kontakte të rregullta me të, ashtu që meqenëse dëshira e nënës time është me qëndru me të, atëherë edhe unë kam dëshirë të qëndroj me nënën time, mirëpo kam dëshirë që të mbaj kontakt me babain dhe vëllaun tim E.H.2.

Nga kontrata e punës për paditësen në Postën D. në Gj., të cilat ishin të përkthyer nga gjermanishtja, u vërtetua se paditësja realizon të ardhura mujore në shumë prej ... €, për 5 orë punë, ndërsa për 3 orë punë shtesë në një restorant, realizon të ardhura në shumë prej ... €. Nga fotodokumentacioni, u vërtetua se paditësja ka kushte të mira banimi si dhomë fjetje, kuzhinë, banjo dhe dhomë ndeje të rregulluara mirë.

5.Ligji i aplikueshëm

Me nenin 139 par.1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, është përcaktuar *‘nëse prindërit jetojnë ndaras, kujdesin prindëror e ushtron prindi me të cilin jeton fëmija nëse me këtë pajtohet prindi tjetër’*. Neni 144 par.1 dhe 2 të Ligjit të lartë përmendur, thotë *‘gjkata ose organi i kujdestarisë i cili merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme ti hetoj të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës, ndërsa nëse fëmija është me moshë mbi 10 vjet, gjykata do të marrë parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës’*. Në rastin konkret duke pas për bazë deklarin e palëve, gjykata vërtetoi se pas ndarjes paditësja është pajtuar që fëmija E.H.1 ti mbetet në përkujdesje prindërore të paditurit, ndërsa tani i padituri pajtohet me padinë e paditëses që fëmija ti besohet asaj në ruajtje dhe edukim, andaj gjykata vlerëson se në mes të palëve nuk është kontestues çështja e besimit të fëmijës, po ashtu edhe nga dëshira e fëmijës, u vërtetua se ky mos kontestim i përgjigjet interesave të fëmijës.

Me nenin 39 par. 2 është paraparë *‘Bashkësia faktike (bashkësia jashtë martesore) është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke dhe të drejtat pasurore ashtu siç është specifikuar me këtë ligj’*.

6.Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata konstatoi se në mes palëve ndërgjyqësore nuk është kontestuese besimi i fëmijës së përbashkët E.H.1, ashtu siç nuk ishte kontestuese mbajtja dhe caktimi i kontakteve.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave materiale të cilat u elaboruan më lartë dhe pas kryerjes së hetimit në mënyrë të përshtatshme të të gjitha rrethanave që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik për edukimin e fëmijës së mitur E.H.1, gjykata erdhë në përfundim se në rrethanat e tanishme të njëjtin duhet t’ia besoj në ruajtje, kujdes dhe edukim nënës së tij B.A., pasi vlerësoi se kjo është në interesin më të mirë të fëmijës, duke marrë për bazë se i padituri nuk e kundërshtoi kërkesën e paditëses ai u pajtua që fëmija ti besohet në rritje dhe edukim të mëtejshëm asaj, ashtu edhe në bazë të dy raporteve të qendrave sociale në P. dhe F.K., e sidomos deklarimi i fëmijës E.H.1 dëshira e të cilit ishte që tani e tutje të jetoj me nënën e tij.

Nga rrethanat e cekura më lartë gjykata e aprovoi kërkesën e paditëses dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerësoi se e njëjta në rrethanat e tanishme i plotëson të gjitha kushtet të cilat sigurojnë mirëqenien e fëmijës dhe ndihmon në zhvillimin emocional të tij, përfshirë kushtet e banimit, ambientin familjar, të ardhurat financiare, përkujdesjen familjare, andaj konform nenit 139 par.2 të LFK-së, vendosi që fëmija i mitur E.H.1 ti besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim paditëses B.A.. Në këtë përfundim gjykata erdhi pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave materiale dhe rrethanave tjera relevante, përfshirë këtu edhe raportet e QPS në P. dhe atij në F.K., të cilat kanë dhënë mendime përafërsisht të njëjta, bazën ekonomike të paditëses, meqenëse e njëjta realizon të ardhura nga puna e saj, përfshirë këtu kushtet e banimit, të ardhurat financiare, shkollimin e fëmijës së mitur etj. Nga këto rezultoi se paditësja ka kushte të mira banimi, ka të ardhura financiare të mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e fëmijës dhe ka ambient të përshtatshëm për rritjen e tij.

Andaj gjykata duke i dhënë kujdes të veçantë ruajtjes dhe shëndetit psikik e fizik të fëmijës dhe zhvillimin e edukimin e tij normal dhe duke pas parasysh gjithmonë interesin më të mirë të fëmijës, konsideron që është e drejtë që fëmija tani të mbetet me të ëmën, mbështetur në nenin 50 pika 1 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 2 të Deklaratës për të drejtat e fëmijës të vitit 1959, vendosi si në pikën I të dispozitivit, konform dispozitës së nenit 139 lidhur me nenin 140 dhe 144 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës.

Gjykata në zbatim të nenit 145 par.1 të LFK-së, caktoi kontaktet personale të paditurit me fëmijën e mitur Enxhëll Haziri, mirëpo vendosi që ato të jenë të lira meqenëse prindërit kishin marrëveshje për mënyrën e mbajtjes së kontakteve me fëmijën i cili tani është i moshës ...vjeç.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në dispozitën e nenit 347 LFK-së, citojmë: "gjykata vendos sipas diskrecionit të saj mbi shpenzimet e procedurës", meqenëse paditësja ka paguar taksën gjyqësore për padi në shumë prej 50 €, ndërsa shpenzime të tjera nuk pati.

Mbi bazën e të lartë cekurave në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 3 të pjesës së I të Konventës mbi të drejtat e fëmijës, të viti 1989, Deklaratës për të drejtat e fëmijës, Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe dispozitave të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA TEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.2689/18 me dt.11.12.2018

G j y q t a r j a,
Naime Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.